REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT

Nr. 371 prot.

Tiranë, më 30.07.2025

URDHËR

Nr 42 datë 30 / 07 /2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT PËR VITIN 2025-2027"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit", Rregullores së Brendshme Nr. 1058 datë 04.12.2024 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit", Vendimit nr. 859, datë 26.12.2024 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2024-2030" Planit të Veprimit 2024-2030 në zbatim të saj, dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës" shkresës me Nr.prot.7516 date 04.06.2025 "Dërgohet kërkesa për hartimin e Planit të Integritetit", me Nr.318 Prot hyrës datë 09.06.2025, si dhe Urdhrit Nr. 37, datë 10.06.2025, Nr. 324 Prot datë 10.06.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit 2025-2027 për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, për periudhën 2025 – 2027, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Plani i Integritetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohen të gjithë nëpunësit e institucionit për njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Pranvera FAGU

Adresa: Tiranë – Rruga e Durrësit, Nr.27,Kati:III-të.Tel:+355 4 2269097; e-mail: info@dpa.gov.al